

**NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prizren**, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari njëherit edhe kryetari i trupit gjykues Xheladin Osmani, me sekretaren juridike Fatmire Kastrati, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit D. M. Prizreni, për shkak të veprës penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.2 nenp.2.1 dhe veprës mbajtja në pronësi, në kontrollë në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KP-ës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.65/2015, të datës 23.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.07.12.2015, në praninë e Prokurorit të shtetit Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. A. J., po të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I AKUZUARI:**

**D. M.**, nga i ati R. dhe e ëma Z., me mbiemër të vajzërisë G., i lindur me datën ... në Prizren, ku edhe jeton, shqiptarë, shtetas i R. të Kosovës, analfabet, i pamartuar i gjendjes së dobët ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

**I.**

Me datë 26.03.2015, në periudhën kohore prej orës 15.30 min, deri në ora 18:00 , e merr dhe e mban të mbyllur në shtëpinë e tij familjare viktimën e ndjeshme të miturin B. H., në atë mënyrë që të njëjtin e fton në shtëpinë e tij kinse për ti ndihmuar për të prer dru, e më pas e mashtron dhe e fton brenda në dhomë, ia mbyll derën me çelës dhe fillimisht e godet me një shuplakë në fytyrë dhe duke iu kërcnuar me një revole dhe thikë, ia lidhë këmbët dhe duar , derisa gojën ia mbyll me një peshkir pastaj me shkelma dhe shuplaka e godet nëpër trup, derisa i dëmtuari B. pas dhënjës së rezistencës, arrin ti liroj duart dhe këmbët dhe të hiki.

Kësodore ka kryer veprën penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.2 nenp.2.1 të KP.

II. Më datë 30.03.2015, rreth orës 11:00, në Prizren, në shtëpinë e tij është gjetur dhe konfiskuar një armë zjarri –pistoletë e tipit “Ecol special 99 “ me numër serie EV-1357469 me një karikator të zbrazet të cilën i pandehuri ka poseduar në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Kësodore kryen veprën penale, mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KP-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 3, par.1,7,8,9,10,42 par1 pika 1, 43 par.1.3, 45, 46, 73,74,dhe 75, si dhe nenit 196 par.2 nenp.2.1 dhe nenit 374 par.1 të KP , të akuzuarin D. M. e

## G J Y K O N

Për veprën penale të përshkruar si nën I/ të dispozitivit të aktakuzës, vepra penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.2 nenp.2.1 të KP, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve.

Për veprën penale të përshkruar si nën II/ të dispozitivit të aktakuzës, vepra penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP ia shpall dënimin me gjobë në shumën prej 500,00 (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguajë në 5 (pesë) kiste, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 Euro të dënimit me gjobë do ti caktoj një(1) ditë burgu.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrestin shtëpiak prej datës 28.03.2015 gjërë më 28.05.2015 në dënimin e shqiptuar. .

Gjykata, në bazë të nenit 328 par. 3 e lidhur me nenin 69 të KP, ndaj të akuzuarit shqipton dënim plotësues;

### MARRJEN E SENDIT

Ashtu që prej të akuzuarit mirret pistoleta e tipit “Ecol special 99” me nr. serie EV-1357469 dhe një karikator i zbrazur.

I dëmtuari B. H., me anë të përfaqësuesit të tij ligjor - prindit B. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari, të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 Euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë, PP.nr.65/2-15 të datës 23.10.2015, kundër të akuzuarit D. M. Nga Prizreni, për shkak të veprës penale privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.2 nenp.2.1 dhe veprës mbajtja në pronësi, në kontroll në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KP-ës,

Aktakuza në fjalë gjatë seancës fillestare e ka përfaqësuesi Prokurori i shtetit Metush Biraj i cili propozojë që të veprohet konform dispozitave të KPP, meqenëse aktakuza është e bazuar në prova të pranueshme.

Në seancën fillestare, i akuzuari u udhëzua në kuptim të nenit 246 të KPP për të drejtat e tij që për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose mos të përgjigjet në pyetje, dhe nëse deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminoj vetveten ose të afërmit, e as të pranoj fajsinë, ta kundërshtoj aktakuzën, dhe papranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë dhe pasi që të drejtat e tija janë respektuar, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka kuptuar aktakuzën i është ofruar mundësia e tij të pranohet fajësinë dhe deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Kryetari i trupit gjykues, vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari e pranoi fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe atë pas marrjes së mendimit të prokurorit, dhe vet të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, mori vendimin mbi pranimin e fajësisë e pastaj është vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke u thirrur në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.nr.207/13 të dt.19.03.2013, ku ndër të tjera është theksuar se nëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjykatësit të vetëm apo kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtari i vetëm përkatësisht kryetari i trupit gjykues, vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin dmth. janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohet me ligj, në një situatë të tillë gjyqtari i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund të vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim si dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupin gjykues ta përmban tre gjykatës profesionist.

Me vet pranim, nga ana e të akuzuarit u vertetue në tërsi se i akuzuari më datën 26.03.2015, në periudhën kohore prej orës 15.30 min, deri në ora 18:00, e merr dhe e mban të mbyllur në shtëpinë e tij familjare viktimën e ndjeshme, të miturin Bernard Hoti, në atë mënyrë që të njëjtin e fton në shtëpinë e tij kinse për ti ndihmuar për të prer dru, e më pas e mashtron dhe e fton brenda në dhomë, ia mbyll derën me çelës dhe fillimisht e godet me një shuplakë në fytyrë dhe duke iu kërcënuar me një revole dhe thikë, ia lidhë këmbët dhe duart, derisa gojën ia mbyll me një peshkir pastaj me shkelma dhe shuplaka e godet neper trup, derisa i dëmtuari Bernard pas dhënies së rezistencës, arrin ti liroj duart dhe këmbët dhe të hiki.

Gjithashtu me vet pranimin nga ana e të akuzuarit, u vërtetua se i akuzuari më datë 30.03.2015, rreth orës 11:00, në Prizren, në shtëpinë e tij është gjetur dhe konfiskuar një armë zjarri –pistoletë e tipit “Ecol special 99 “ me numër serie EV-1357469 me një karikator të zbrazet të cilën i pandehuri ka poseduar në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e poashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprat penale që i vihen në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari në aspektin penalo- juridik është përgjegjës për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73 të KP, pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese muar për bazë nenin 75 par.1.3 të KP, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe nenin 74 të KP, është marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, është i gjendjes tejet të dobët ekonomike, është penduar, ia ka dhënë fjalën gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, dhe gjërë më tani i padënuar, për këtë, për veprën e parë ia shqiptoj një dënim më të butë, të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit u muar në kuptim të nenit 374 par.3 të KP-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**P.nr.200/2015, me date: 07.12.2015**

**Sek. juridike,  
Fatmire Kastrati**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Xheladin Osmani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën së Apelit në Prishtinë.